

VENDIM
Nr. 15, datë 9.6.2014

**PËR ZBATIMIN E KONTRATËS MODEL, TË MIRATUAR NGA KKRR, PËR TË GJITHË
KLIENTËT E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, nenit 3, nenit 13, pika “d”, nenit 14, pika “e”, “i”, “j” dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në nenet 663-676 të tij, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Marrëdhënia juridike e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura midis operatorëve dhe klientëve rregullohet në bazë të kontratës model, të miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 8, datë 4.2.2011, “Për miratimin e modelit të kontratës tip”.

2. Pika 5 e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 8, datë 4.2.2011, “Për miratimin e modelit të kontratës tip” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 shtator 2014.

KRYETARI
Avni Dervishi